

VENDIM
Nr. 21, datë 3.3.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Illir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 3.3.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 22 (A) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Alket Çela

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Agjencia e Trajtimit të Pronave, në mungesë.

Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, përfaqësuar nga avokatet e shtetit Irma Qosja dhe Valbona Legisi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-5007, datë 17.12.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes nr. 14229 (31138-001164-86-2021), datë 9.4.2021, nga Gjykata Administrative e Apelit brenda një afati të arsyeshëm.

Urdhërimi i marrjes së masave të nevojshme dhe të domosdoshme për gjykimin sa më të shpejtë të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “F”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit Alket Çela (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit tjetër të interesuar, Agjencisë së Trajtimit të Pronave (*ATP*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi, në cilësinë e trashëgimtarit ligjor dhe përfaqësuesit të trashëgimtarëve të ish-pronarit A.Ç. (M.), i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi, me objekt vlerësimin financiar të vendimit nr. 184, datë 26.6.2009 të ish-Zyrës

Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Qarku Tiranë (*ZRKKP-ja, Tiranë*) në emër të subjektit të shpronësuar, me palë të paditur ATP-në, e cila është përfaqësuar në gjykim nga Avokatura e Përgjithshme e Shtetit.

2. Me vendimin nr. 364 (80-2021-377), datë 15.2.2021, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, vlerësimin financiar të vendimit nr. 184, datë 26.6.2009 të ZRKKP-së, Tiranë për sipërfaqen 39.000 m² të llojit “tokë bujqësore”, të ndodhur në zonën kadastrale nr. 2291, fshati Kryemëdhenj, ish-komuna Golem, i Bashkisë Kavajë, në shumën 12.831.000 lekë dhe detyrimin e palës së paditur të bëjë pasqyrimin e vendimit në regjistrin e vendimeve përfundimtare të kompensimit. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim pala e paditur, ATP-ja, si dhe Avokatura e Shtetit.

3. Çështja është regjistruar për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 14229 (31138-01164-86-2021), datë 9.4.2021. Në datat 23.1.2024 dhe 2.10.2024 kërkuesi i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesa për përshpejtimin e gjykimit të çështjes bazuar në vendimin nr. 78, datë 30.5.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit” (*vendimi nr. 78/2019 i KLGJ-së*). Më pas, në datën 6.11.2024, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenet 399/1, 399/2, pikat 1, shkronja “a” dhe 2, si dhe 399/6, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*).

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-5007, datë 17.12.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se çështja nuk është pezulluar ose shtyrë gjykimin për shkak të kërkesave të palës kërkuese, nuk konstatohet ndonjë sjellje e palëve që të ketë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit, për sa kohë që nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit e deri në ato momente nuk është kryer ndonjë veprim procedural, si dhe çështja nuk paraqitet komplekse nga natyra e saj. Ndërsa mosveprimi i gjykatës së apelit ka ardhur si rezultat i volumit të madh të çështjeve, të mbetura pa gjykuar për një kohë të gjatë, në raport me një pamjaftueshmëri burimesh njerëzore për të përballuar këtë volum, sepse një situatë e tillë e vë organin gjyqësor në kushtet e pamundësisë objektive për procedim dhe ka të bëjë me një problematikë që përfshin sistemin në tërësi. Po kështu, mosveprimi i gjykatës së apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive, që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit. Gjyqtari relator ka deklaruar se është deleguar në atë gjykatë në muajin tetor të vitit 2023 dhe për shqyrtimin e çështjes zbaton rendin kronologjik.

5. Në datën 1.4.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të Ligjit Organik të saj, është regjistruar në datën 17.4.2025. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 18.6.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 24.6.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Në datën e planifikuar për zhvillimin e seancës gjyqësore, në gjykimin e çështjes nuk ka marrë pjesë një gjyqtar për arsye objektive të lidhura me ushtrimin e detyrës.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtuar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektin e:

6.1. *Së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi çështja e regjistruar në datën 9.4.2021 në Gjykatën Administrative të Apelit nuk është shqyrtuar ende, duke tejkaluar afatin e përcaktuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja “a”, të KPC-së. Kërkuesi ka paraqitur kërkesa për përshpejtimin e gjykimit, bazuar në vendimin nr. 78/2019 të KLGJ-së, kërkesa të cilat janë refuzuar.

6.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm pa analizuar interesat kushtetues të pronësisë dhe rrethanat e ecures së kësaj çështjeje në organet administrative dhe gjyqësore. Në këtë vendim nuk është analizuar as rreziku që passjell tejzgjatja e afateve të gjykit, por kjo tejzgjatje është përligjur nga Gjykata e Lartë, duke e lënë çështjen në diskrecion të Gjykatës Administrative të Apelit sipas rendit kronologjik. Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur në konsideratë qëndrimin e Gjykatës se ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që justifikon vonesën në gjykim.

7. Subjekti i interesuar, Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, ka prapësuar si vijon:

7.1. Pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në aspektin e *së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm* është i pabazuar, pasi kërkuuesi nuk ka arritur të paraqesë argumente të mjaftueshme për të provuar cenimin e kësaj të drejte. Afati i gjykit të çështjes formalisht ka tejkaluar afatin 1-vjeçar të përcaktuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja "a", të KPC-së. Për sa i përket sjelljes së kërkuarit, nuk rezulton që çështja të jetë pezulluar ose shtyrë për shkak të kërkesave të palëve, pra sjellja e tij nuk ka ndikuar në kohëzgjatjen e procesit. Çështja objekt gjykimi ka natyrë administrative, me objekt vlerësimin financiar të vendimit të ZRKKP-së, Tiranë në emër të subjektit të shpronësuar dhe nuk është komplekse. Në lidhje me sjelljen e autoriteteve, nuk mund të konstatohet shkelje e afatit të arsyeshëm, për sa kohë vonesa në gjykimin e çështjes vjen si pasojë e pamundësisë objektive dhe jo për shkak të neglizhencës së gjyqtarit ose administrimit të parregullt gjyqësor. Po kështu, për sa kohë çështja e kërkuarit ka të bëjë me vlerësimin financiar të vendimit të ZRKKP-së, Tiranë, ai nuk ka arritur të argumentojë ose provojë sesi interesi i tij rrezikohet për shkak të vonesës së gjykit në gjykatën e apelit. Çështja lidhet me interesa vetjakë, siç është e drejta e pronës, por jo me interesa jetësorë, të tillë që do të kërkonin shqyrtimin me përparësi të saj në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

7.2. Pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit është i pabazuar, pasi vendimmarrja e Gjykatës së Lartë është e arsyetuar, ezaures dhe e mbështetur në dispozitat procedurale civile, si dhe respekton objektin e kërkesës.

8. Subjekti i interesuar, ATP-ja, nuk ka paraqitur shpjegime me shkrim, ndonëse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Gjykata vlerëson se kërkuuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, kërkuesi, bazuar në nenet 399/1 e vijuese të KPC-së, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, kërkesë e cila është rrëzuar me vendimin nr. 00-2024-5007, datë 17.12.2024. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuetit për rivendosjen në vend të së drejtës së cenuar është ankimi kushtetues individual.

12. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm është i datës 17.12.2024, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 1.4.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i Ligjit Organik të Gjykatës.

13. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vëren se pretendimet për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë janë në funksion të pretendimit kryesor për tejzgjatjen e procedurave gjyqësore, i cili, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohet në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

14. Kërkuesi ka pretenduar se çështja e regjistruar në datën 9.4.2021 në Gjykatën Administrative të Apelit nuk është shqyrtuar ende, duke tejkaluar afatin e përcaktuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja "a", të KPC-së dhe ndonëse ai ka paraqitur kërkesa për përsheptim, bazuar në vendimin nr. 78/2019 të KLGJ-së, ato janë refuzuar. Sipas kërkuetit, Gjykata e Lartë ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm pa analizuar interesat kushtetues të pronësisë dhe rrethanat e ecures së kësaj çështjeje në organet administrative dhe gjyqësore. Sipas kërkuetit, Gjykata e Lartë nuk ka analizuar as rrezikun që passjell tejzgjatja e afateve të gjykimit, por kjo tejzgjatje është përligjur prej saj, duke e lënë çështjen në diskrecion të Gjykatës Administrative të Apelit sipas rendit kronologjik. Po kështu, sipas tij, Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur në konsideratë qëndrimin e Gjykatës se ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që justifikon vonesën në gjykim.

15. Subjekti i interesuar, Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, ka prapësuar se pretendimi i kërkuetit është i pabazuar, pasi ai nuk ka arritur të paraqesë argumente të mjaftueshme për të provuar cenimin e kësaj të drejte. Ndonëse afati i gjykimit të çështjes formalisht ka tejkaluar afatin 1-vjeçar të përcaktuar në dispozitën procedurale civile, çështja nuk rezulton të jetë pezulluar ose shtyrë për shkak të kërkesave të palëve dhe ajo nuk paraqitet komplekse. Gjithashtu, nuk mund të konstatohet shkelje e afatit të arsyeshëm për sa kohë vonesa në gjykimin e çështjes vjen si pasojë e pamundësisë objektive dhe jo për shkak të neglizhencës së gjyqtarit ose administrimit të parregullt gjyqësor. Po kështu, sipas subjektit të interesuar, për sa kohë çështja ka të bëjë me vlerësimin financiar të vendimit të ZRKKP-së, Tiranë, kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë ose provojë sesi interesi i tij rrezikohet për shkak të vonesës së gjykimit në gjykatën e apelit. Çështja lidhet me interesa vetjakë, siç është e drejta e pronës, por jo me interesa jetësorë, të tillë që do të kërkonin shqyrtimin me përparësi të saj në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

16. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 61, datë 21.10.2025; nr. 57, datë 17.9.2024; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuksi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi, me objekt vlerësimin financiar të vendimit nr. 184, datë 26.6.2009 të ZRKKP-së, Tiranë në emër të subjektit të shpronësuar, me palë të paditur ATP-në. Kjo gjykatë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, vendim i cili është ankimuar nga pala e paditur dhe Avokatura e Shtetit. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 9.4.2021, pra deri në momentin e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual kanë kaluar rreth 4 vjet e 10 muaj dhe ende nuk ka një vendimmarrje për themelin e saj.

18. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata ka theksuar se neni 48 i ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar parashikon afatin 30-ditor për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallë të dytë (neni 399/2, pika 1, shkronja “a”, i KPC-së). Kjo nënkupton se formalisht gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit ka tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor.

19. Gjykata ka pohuar se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave, në kuptim të rrethanave të veçanta të çështjes konkrete, vlerësohet nën dritën e këtyre kriterëve: (i) sjellja e kërkuksit; (ii) kompleksiteti i çështjes; iii. sjellja e autoriteteve; iv. rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuksi.

20. Gjykata thekson se, për sa u përket kriterëve që kanë të bëjnë me sjelljen e kërkuksit, kompleksitetin e çështjes dhe sjelljen e autoriteteve, bazuar në qëndrimin e konsoliduar të saj për vlerësimin e tyre (*shih vendimet nr. 61, datë 21.10.2025; nr. 57, datë 17.9.2024; nr. 6, datë 16.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese*), nuk konstatohet ndonjë shkak ose rrethanë e re, ose e ndryshme për të arritur ajo në një qëndrim të ndryshëm për sa i përket respektimit të tyre. Për rrjedhojë, për të vlerësuar arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor, Gjykata vlerëson të ndalet në vijim vetëm në analizën e kriterit të *asaj se çfarë rrezikon kërkuksi* në rastin konkret për shkak të vonesave në gjykimin e çështjes së tij.

21. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se disa çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë” nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi, të tillë si ata që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin etj., edhe pse kjo listë nuk mund të jetë shteruese dhe interesi i kërkuksit verifikohet rast pas rasti (*shih vendimet nr. 43, datë 4.6.2024; nr. 21, datë 4.4.2024; nr. 6, datë 16.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në analizë të kriterëve si më sipër, Gjykata vëren se në rastin në shqyrtim thelbi i çështjes gjyqësore të vënë në lëvizje nga kërkuksi ka të bëjë me vlerësimin financiar të një prone të njohur ish-pronarit të shpronësuar me vendim të ZRKKP-së, Tiranë. Kjo çështje, sikurse ka pranuar subjekti i interesuar, për nga natyra e saj, edhe pse nuk lidhet drejtpërdrejt me interesa jetësorë, që kërkojnë trajtim me përparësi, lidhet me të drejtën e pronës dhe proceset e kthimit dhe kompensimit të pronave. Për këto të fundit, Gjykata ka pohuar se shqyrtimi i këtyre çështjeve kërkon trajtim me përparësi për shkak të interesit që ato paraqesin për kërkuksit (*shih vendimet nr. 75, datë 20.11.2025; nr. 2, datë 21.1.2025, të Gjykatës Kushtetuese*). Për më tepër, Gjykata vëren se kërkuksi i është drejtuar disa herë gjykatës së apelit me kërkesë për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, duke parashtruar se trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar janë pensionistë dhe në gjendje të rënduar shëndetësore. Në këto rrethana, Gjykata, duke marrë në konsideratë veçoritë e çështjes konkrete, si edhe rëndësinë e interesave që mund të cenohen nga zgjatja e procesit gjyqësor, vlerëson se është provuar ekzistenca e një rreziku real për interesat e kërkuksit, natyra e të cilit justifikon trajtimin me përparësi të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit.

23. Për më tepër, Gjykata i referohet edhe qëndrimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilit një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet si një kohë e

arsyeshme dhe se palët në mosmarrëveshjet civile që nuk kërkojnë ndonjë trajtim të veçantë prioritar, kanë megjithatë të drejtë, sipas nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së, për një proces brenda një afati të arsyeshëm dhe ato nuk janë të detyruara të tregojnë, për këtë qëllim, se u është shkaktuar ndonjë dëm i veçantë ose shtesë nga vonesat procedurale. Sipas asaj gjykate, një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet e arsyeshme kur argumenti i vetëm për vonesën është reforma në sistemin e drejtësisë dhe ngarkesa e gjyqtarëve e krijuar për këtë shkak dhe faktorë të tillë të një natyre të përgjithshme mund të merren parasysh në një masë të përshtatshme në përcaktimin e çdo kohëzgjatjeje të procedurave në një çështje të veçantë, por nuk janë të afta, në vetvete, të justifikojnë vonesa të një mase të tillë (*shih ARB sh.p.k. e të tjerë kundër Shqipërisë, datë 2705.2025, §§§ 111, 118, 122*).

24. Në këtë këndvështrim, Gjykata, duke pasur parasysh se çështja ka mbetur në pritje të shqyrtimit në Gjykatën Administrative të Apelit për një periudhë prej 4 vjetësh e 10 muajsh (e regjistruar në datën 9.4.2021), arrin në përfundimin se është cenuar e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, vendimi nr. 00-2024-5007, datë 17.12.2024 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet. Gjithashtu, për arsyet e mësipërme, Gjykata vlerëson se çështja e kërkuarit duhet të shqyrtohet me përparësi nga Gjykata Administrative e Apelit.

25. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuarit duhet të pranohet sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-5007, datë 17.12.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.
Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 3.3.2026.

Shpallur më 19.3.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Marjana Semini, Genti Ibrahimi